

UDHËZIM
Nr. 22/1, datë 17.9.2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 22, DATË 31.7.2015 “MBI
PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR QARKULLIMIN E MJETEVE TË
HUAJA TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE, TË MË SHUMË SE 20
PERSONAVE, PËRFSHIRË EDHE DREJTUESIN E MJETIT, SI DHE TË MJETEVE
TË TRANSPORTIT TË MALLRAVE ME NGARKESË APO PA NGARKESË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Pikat 5, 6 dhe 7 të udhëzimit ndryshojnë me këtë përmbajtje:

“5. Drejtuesi i mjetit, në momentin e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë me automjete me targë të huaj, kryen pagesën e tarifës së përcaktuar sipas pikës 1 të këtij udhëzimi.

6. Kjo pagesë bëhet me mandat arkëtimi. Dy kopje të mandatarëkëtimin i jepen drejtuesit të mjetit, ndërsa kopja e tretë ruhet në degën doganore hyrëse. Drejtuesi i mjetit, një kopje të mandarit e dorëzon në doganën e destinacionit dhe një kopje e mban për vete.

7. Shumat e tarifave të arkëtuara në degët doganore kufitare regjistrohen në një regjistër të veçantë sipas formularit nr. 1 që i bashkëlidhen këtij udhëzimi”.

2. Formularët nr. 1 dhe nr. 2 që i bashkëlidhen këtij udhëzimi shfuqizohen dhe zëvendësohen me formularin nr. 1 që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

3. Në pikën 8, germa c), kudo në përmbajtje togfjalëshi “Drejtoria e Përgjithshme e Doganave” zëvendësohet me “Degët doganore”.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Shkëlqim Cani

Formulari nr. 1

**REGJISTRI DITOR I TARIFËS SË QARKULLIMIT
TË AUTOMJETEVE TË HUAJA**

Nr.	Lloji i mjetit /Targa	Emri i zotëruesit/i drejtuesit të mjetit	Shteti nga vjen mjeti	Data e hyrjes në RSH	Nr. dhe data e doku mentit të pagesës	Shuma e tarifës së paguar